




KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

## KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



### Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. \_\_\_\_\_/2022

Datë: 30.03.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 5, 6, 8 dhe 14.3 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2022 pas diskutimit lidhur me pikën 4 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale byfet në shkolla, e miratoi këtë:

### V E N D I M

#### Paraparak

Për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale

1. Miratohet vendimi paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale me byfet në shkolla me numër parcelave si vijon:

- Pronën e evidentuar në parcelat me nr. P-70705029-01166-1 në sipërfaqe prej 26.00 m<sup>2</sup>, e evidentuar në zonën kadastrale Gjakovë - Qytet, në objektin e SHME “Kadri Kusari” në Gjakovë;
- Pronën e evidentuar në parcelat me nr. P-70705029-02130 në sipërfaqe prej 12.60 m<sup>2</sup>, e evidentuar në zonën kadastrale Gjakovë -Qytet, në objektin e SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë;
- Pronën e evidentuar në parcelat me nr. P-70705037-00293-1 në sipërfaqe prej 12.00 m<sup>2</sup>, e evidentuar në zonën kadastrale Gjakovë Qytet, në objektin e SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë;
- Pronën e evidentuar në parcelat me nr. P-70705029-00468-1 në sipërfaqe prej 40.49 m<sup>2</sup>, e evidentuar në zonën kadastrale Gjakovë - Qytet, në objektin e Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë;
- Pronën e evidentuar në parcelat me nr. P-70705029-00066-2-002130 në sipërfaqe prej 32.00 m<sup>2</sup>, e evidentuar në zonën kadastrale Gjakovë Qytet, në objektin e SHFMU “Zekeria Rexha” në Gjakovë,

2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale si në pikën 1 të këtij vendimi është afatshkurtër, prej pese (5) viteve.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzimin të pronave është funksionalizimi i byfejave në shkolla dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale.

4. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes njoftimit publik në harmoni me nenin 15 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënin në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

#### 6. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunë së Gjakovës z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë .
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
- Drejtorisë për Arsim .
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit

